



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr _____ prot

Tiranë më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 300, datë 10.06.2024

**PËR
NDRYSHIMIN E PJESSHËM TË VENDIMIT NR. 299, DATË 05.06.2024,
TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR, “PËR CAKTIM GJYQTARI, NË
NJË ÇËSHTJE GJYQËSORE TË VEÇANTË, NË GJYKATËN E POSAÇME TË
APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 113 e 117 të Kodit të Procedurave Administrative në nenet 2 e 89, 99 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, si dhe në kërkesat e dërguara nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe znj. Brikena Ukperaj, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, në përfundim të tij,

V E N D O S I :

I. Ndryshimin e pikës 1, nëndarja “Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, paragrafi I, të Vendimit Nr. 299, datë 05.06.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

“1.Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Irena Brahimi (relatore), Lutfije Celami dhe Dritan Hasani, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Akuza:Nenet 284/1, 28/4, 283/a/1, 28/4, 287/1/b e 25, 333/a/1 dhe 334/1 të Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR